



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT
RREGULLATOR

Nr. 1515/1 prot.

Tiranë, më 05.03.2026

Lënda: Kthim përgjigje

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë

QENDRËS "RES PUBLICA"

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë

Në vijim të shkresës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me nr. 515/1 prot., datë 19.02.2026, të regjistruar në Ministrinë e Arsimit me nr. 1555 prot., datë 23.02.2026 me lëndë: "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ju informojmë, si më poshtë:

Ministria e Arsimit, në përputhje me përgjegjësitë institucionale, ka marrë pjesë në aktivitete, konferenca dhe projekte ndërkombëtare që lidhen me arsimin, bashkëpunimin ndërkombëtar, zhvillimin profesional dhe proceset e integritimit evropian. Këto angazhime burojnë nga detyrimet ligjore dhe ndërkombëtare të institucionit dhe janë pjesë e ushtrimit normal të funksioneve të tij.

Të gjitha procedurat për shpenzimet e udhëtimeve dhe akomodimit janë ndjekur në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, menaxhimin financiar dhe sistemin buxhetor. Pagesat dhe kontraktimet janë realizuar përmes sistemeve elektronike përkatëse, duke garantuar gjurmueshmëri dhe transparencë.

Pas mbledhjes së të dhënave të shumta sipas kërkesës për informim, ju bëjmë me dije shumat e shpenzuara për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025:

- Shuma e shpenzuar për bileta avioni: 2,763,504 lekë.
- Shuma e shpenzuar për akomodim: 31,198 euro.

Destinacionet të udhëtimeve për periudhën e kërkuar janë Itali, Belgjike, Kosovë, Moldavi, Poloni, Greqi, Zvicër, Spanjë, Francë, Hungari, Danimarkë, Tunizi, Izrael, Mali i Zi, UAE, Slloveni.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

